

PËRMBAJTJA

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1-2
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E FITMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	6
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	7 - 25



## RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR

Drejtuar: Menaxhimit dhe Aksionerëve të Shoqërisë Ayen AS Energji sh.a

### Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë Ayen AS Energji sh.a (Shoqëria) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financier më datën 31 dhjetor 2016 , pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllt në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financier të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2016 , dhe performancën financiare dhe flukset e parashë për vitin që mbyllt në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

### Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkuar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

### Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF, dhe për ato kontolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përbajnjë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përvèç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale perveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.


### Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mosbulimit të një anomali si pasojë e mashtimit është më i lartë se rreziku i mosbulimit të një anomali si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësimë të qëllimshme, keqinterpretim, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasiguri materiale mbi aftesinë e Shoqërisë për të vazduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të térheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, perveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.



14 shkurt 2017

**Teit Gjini**  
Auditues Ligjor

**AYEN AS ENERGJI sh.a**

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e pozicionit finanziar**

Më 31 dhjetor 2016

	Shënimë	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
<b>AKTIVE</b>			
<b>Aktivet afatgjata</b>			
Aktivet afatgjata materiale	6	28,959,587,233	22,789,200,125
TVSH e arkëtueshme	10	4,108,435,416	3,642,828,169
Garanci		4,126,450	8,016,530
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		<b>33,072,149,099</b>	<b>26,440,044,824</b>
<b>Aktivet afatshkurtra</b>			
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	7	405,771,664	1,397,940,054
Inventarë	8	19,153,056	274,789,744
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	9	208,207,952	109,924,967
Llogari të arkëtueshme të tjera		2,716,200	-
TVSH e arkëtueshme	10	115,785,855	-
Mjetet monetare në arkë e në bankë	11	145,621,286	1,460,444,734
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>897,256,013</b>	<b>3,243,099,499</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>33,969,405,112</b>	<b>29,683,144,323</b>
<b>KAPITALI</b>			
Kapitali themeltar		11,900,000,000	7,700,000,000
Reduktim i paregjistuar i kapitalit		(166,956,557)	(1,090,091,625)
Fitime të mbartura		(126,158,352)	(154,561,128)
Fitimi i ushtrimit		(31,365,773)	28,402,776
<b>Totali i kapitalit</b>	12	<b>11,575,519,318</b>	<b>6,483,750,023</b>
<b>DETÝRIMET</b>			
<b>Detyrime afatgjata</b>			
Hua afatgjata	13	20,069,032,031	20,779,823,135
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>		<b>20,069,032,031</b>	<b>20,779,823,135</b>
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
Pjesa afarshkurtër e huasë afatgjatë	13	1,126,309,339	-
Interesa të përllogaritura	13	430,176,577	404,615,263
Llogari të pagueshme tregtare	14	762,596,337	2,012,703,204
Llogari të pagueshme të tjera	15	5,771,510	2,252,698
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>2,324,853,763</b>	<b>2,419,571,165</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>22,393,885,794</b>	<b>23,199,394,300</b>
<b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>		<b>33,969,405,112</b>	<b>29,683,144,323</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 25, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



**AYEN AS ENERGJI sh.a**

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshtirëse

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

Shënimë	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	16	413,481,215
Të ardhura të tjera		2,821,220
<b>Total të ardhura</b>		<b>416,302,435</b>
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	17	(88,386,293)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	6	(396,390,044)
Shpenzime personeli	18	(91,532,420)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	19	(152,983,344)
<b>Total shpenzime</b>		<b>(729,292,101)</b>
Shpenzime interesi dhe të ngjashme (neto)	20	24,614
Shpenzime të tjera financiare (neto)	20	281,599,279
<b>Fitimi/humbja para tatimit</b>		<b>(31,365,773)</b>
<b>Shpenzimi i tatimit mbi fitimin</b>	21	-
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		-
Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë		-
<b>Fitimi/humbja e vitit</b>		<b>(31,365,773)</b>
Të ardhura të tjera gjithpërfshtirëse për vitin		-
<b>Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshtirëse për vitin</b>		<b>-</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithpërfshtirëse për vitin</b>		<b>(31,365,773)</b>
		<b>28,402,776</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 25, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



**AYEN AS ENERGJI sh.a**  
*(Vlerat janë në Lek)*

Pasqyra e Ndryshimeve në kapital  
 Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

	Kapitali i nënshtkuar	Kapitali i regjistruar i papaguar	Fitimet e Pashpërndara e vitit	Fitim / Humbja e vitit	Totali
<b>Pozicioni finansiar më 1 Janar 2015</b>	<b>4,900,000,000</b>	<b>(996,688,376)</b>	<b>(81,060,625)</b>	<b>(73,500,503)</b>	<b>3,748,750,496</b>
Fitimi / Humbja e vitit				28,402,776	28,402,776
Transferim në fitimet e mbartura / humbjet e akumuluara			(73,500,503)	73,500,503	-
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njoftura direkt në kapital:		(93,403,249)			(93,403,249)
Emetimi i kapitalit të nënshtkuar		2,800,000,000			2,800,000,000
Dividendë të paguar				-	
<b>Pozicioni finansiar më 31 dhjetor 2015</b>	<b>7,700,000,000</b>	<b>(1,090,091,625)</b>	<b>(154,561,128)</b>	<b>28,402,776</b>	<b>6,483,750,023</b>

Fitimi / Humbja e vitit				-	
Transferim në fitimet e mbartura / humbjet e akumuluara				(31,365,773)	(31,365,773)
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njoftura direkt në kapital:		923,135,068		28,402,776	(28,402,776)
Emetimi i kapitalit të nënshtkuar		4,200,000,000			923,135,068
Dividendë të paguar				4,200,000,000	-
<b>Pozicioni finansiar më 31 dhjetor 2016</b>	<b>11,900,000,000</b>	<b>(166,956,557)</b>	<b>(126,158,352)</b>	<b>(31,365,773)</b>	<b>11,575,519,318</b>

Pasqyrat finansiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpieguese nga faqja 7 deri në 25, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat finansiare të Shqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 janë aprovuar nga administratori i Ayen AS Energji sh.a më 14 Shkurt 2017 dhe janë firmosur si më poshtë.



Fahrettin Amir Arman  
 Administrator

## Pasqyra e Flukseve Monetare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

Shënimi	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
<b>Flukset e parasë nga aktivitetet operative</b>		
Fitimi para tatimit	(31,365,773)	28,402,776
<i>Axhustime për zërat jo-monetare:</i>		
Zhvlerësimi dhe amortizimi	396,390,044	272,246,019
Diferencat e kembimit nga aktiviteti jo operativ	(315,883,759)	(390,024,198)
<i>Ndryshimi ne kapitalin qarkullues</i>		
Ndryshimi në parapagime e shpenzime të shtyra	992,168,390	(828,147,178)
Ndryshimi në garancitë	3,890,080	483,800
Ndryshimi në TVSH e arketueshme	(581,393,102)	(1,118,517,388)
Ndryshimi në inventar	255,636,688	108,495,969
Ndryshimi në llogari të arketueshme	(100,999,185)	(109,924,967)
Ndryshimi në llogari të pagueshme	(1,250,106,867)	9,811,737
Ndryshimi në llogari të pagueshme të tjera	3,518,812	403,743
<b>Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative</b>	<b>(628,144,672)</b>	<b>(2,026,769,687)</b>
<b>Aktivitetet investuese</b>		
Blerje të aktiveve afatgjata materiale	(5,399,976,429)	(6,178,489,696)
Shitje aktivesh afatgjata	-	48,609,058
<b>Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues</b>	<b>(5,399,976,429)</b>	<b>(6,129,880,638)</b>
<b>Aktivitetet financuese</b>		
Kontribut nga pronaret	5,123,135,068	2,706,596,751
(Ripagim)/ te hyra nga hua	712,953,857	4,486,396,344
Pagesat e kostos së huasë	(1,122,791,272)	(920,136,265)
<b>Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues</b>	<b>4,713,297,653</b>	<b>6,272,856,830</b>
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	(1,314,823,448)	(1,883,793,495)
Mjetet monetare në fillim të periudhës	11	1,460,444,734
<b>Mjetet monetare në fund të periudhës</b>	<b>11</b>	<b>145,621,286</b>
		<b>1,460,444,734</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 25, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



## 1. Informacion i përgjithshëm

Ayen AS Energji sh.a. ("Shoqëria") është themeluar dhe e zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar. Shoqëria është regjistruar në datën 31 maj 2011 në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR), me NIPT L11731504A dhe aktualisht raporton pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë.

Adresa e regjistruar e Shoqërisë është: Rruga "Papa Gjon Pali i II-te", ABA Business Center, Kati 11, Njesia Bashkiake Nr.2, Tirana.

Kapitali aksionar i shoqërisë përbëhet nga 119,000 aksione me vlerë nominale LEK 100,000, për një vlerë totale LEK 11,900,000,000. Aksionerët e shoqërisë janë:

- Ayen Enerji Anonim Sirketi 82%
- AS Energy 9%
- Ayel Elektrik Uretim Sanayi ve Ticaret Anonim Sirketi 8%
- Z. Fahrettin Amir Arman 1%

Më 31 dhjetor 2016, shoqëria ka 57 punonjës (31 dhjetor 2015: 42).

Objktivi kryesor i Shoqërisë përbëhet nga planifikimi, ndërtimi, mirëmbajtja dhe operimi i tre hidrocentraleve me një kapacitet të instaluar, të kombinuar prej rreth 109.71 MW në Peshqesh, Ura e Fanit dhe Fangut dhe shitjen e energjisë elektrike të prodhuar në Shqipëri dhe jashtë vendit, si dhe ndonjë veprimtari tjeter biznesi të lejuara që janë të nevojshme apo të dobishme për të përm bushur objektivin e saj.

Ndërtimi i Hidrocentralit i PESHQESHIT 3 ka përfunduar më 4 maj 2015, kapaciteti i instaluar dhe kapaciteti vjetor i prodhimit është 34 MW dhe 118,400,000 kWh respektivisht.

## Marrëveshja e Koncessionit dhe ndryshimet – terma të rëndësishëm

Sipas:

- Nenit 78 dhe 83 të Kushtetutës së Shqipërisë;
- Ligjit shqiptar Nr. 9663 "Për koncessionet" i datës 18 dhjetor 2006;
- Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 147 "Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncession të kaskadës së hidrocentraleve në lumin Fan i Vogël dhe miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurese që i jepet Shoqërisë" më datë 11 shtator 2011;
- Kontratës së koncessionit rep nr. 5446, col nr. 1944, më datë 2 maj 2011 të aprovuar nga Vendimi Nr. 365 më datë 5 maj 2011, i cili hyri në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare nr. 62 më datë 23 maj 2011.
- Kontratë koncensioni shtese e aprovuar nga Vendimi Nr. 442 më datë 22 Maj 2013
- Kontratë knçesioni shtese e aprovuar me Vendimin Nr. 51 më datë 25.01.2017, e cila hyri në fuqi menjehere pas publikimit ne Fletoren Zyrtare më datë 2 Shkurt 2017.

Sipas Marrëveshjes së Koncessionit, Shoqëria koncessionare është e lejuar që të furnizojë prodhimin neto të energjisë elektrike brenda ose jashtë Shqipërisë (që do të prodhohet nga koncessionari). Marrëveshja e Koncessionit përbën një model projekt i tipit BOT (Ndërtim-Operim-Transferim) dhe do të zgjasë për një periudhë prej 41 vjetësh (35 vjet me një zgjatje prej 6 vitesh e aprovuar nga vendimi Nr. 442 më datë 22 Maj 2013) me të drejtë zgjatjeje automatike pas përbushjes së disa kushteve të përcaktuara në Marrëveshjen e Koncessionit. Pas kësaj periudhe hidrocentrali do t'i transferohet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitetikës (METE) pa asnjë tarifë bashkë me pajisjet e lidhura operuese, të drejtat dhe kontratat. Koncessionari do të ndërtojë tre Hidrocentrale: "Peshqesh", "Ura e Fanit", "Fangu" (siç specifikohet në shtesën e kontratës së koncessionit aprovuar nga vendimi Nr. 51 më datë (25.01.2017) me një kapacitet total te instaluar prej 109.71 MW. Investimi total është 210,184,740 Euro (siç specifikohet në shtesën e kontratës së koncessionit aprovuar nga vendimi Nr.51 më datë 25.01.2017)



**2. Aplikimi i standardeve ndërkontinentare të raportimit financiar të reja dhe të rishikuara**

**2.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale**

Standardet dhe interpretimet e mëposhtme aplikohen në periudhat e raportimit financiar që fillojnë me ose pas datës 1 janar 2016.

- *Ndryshimet në SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 28 - Njësitë investuese: Aplikimi i përjashtim të konsolidimit (publikuar ne dhjetor 2014 dhe efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 janarit 2016)*
- *Ndryshimet në SNRF 11 "Marrëveshjet e përbashkëta" Kontabiliteti për Blerjet e interesave në operacione të përbashkëta - (publikuar ne Maj te 2014 dhe efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016).*
- *SNRF 14 "Llogaritë shtyra për arsyen rregullatore" (publikuar ne janar 2014 dhe efektiv për periudhat që fillojnë më 1 Janar 2016)*
- *Ndryshimet në SNK 1 Paraqitura Fillesare (publikuar në dhjetor 2014 dhe efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016)*
- *Ndryshimet në SNK 16 dhe SNK 38 - Sqarimi i metodave të pranueshme të Zhvlerësimi dhe Amortizimi (publikuar në maj 2014 dhe efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016)*
- *Ndryshimet në SNK 16 dhe SNK 41 "Bujqësia: Bimët Bartëse" - (publikuar në Qershor 2014 dhe efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 shkurt 2016)*
- *Ndryshimet në SNK 27 - Metoda e kapitalit neto në pasqyrat financiare të veçanta (publikuar në Gusht 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016)*

**2.2 Standardet dhe interpretimet e emetuara por ende të pa përvetësuara**

- *Ndryshime në SNRF 9 - "Instrumentat Financiar"*
- SNRF trajton klasifikimin, matjen dhe mosnjohjen e aktiveve financiare dhe pasiveve financiare, fut rregulla të reja për kontabilitetin mbrojtës dhe një model të ri zhvlerësimi për aktivet financiare. (Duhet të jetë aplikuar për vitet financiare fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).
- *Ndryshimet në SNRF 15 "Të ardhurat nga kontratat me klientët". BSNK ka nxjerrë një standard të ri për njohjen e të ardhurave. Kjo do të zëvendësojë SNK 18, i cili mbulon kontratat përmallra dhe shërbime dhe SNK 11, i cili mbulon kontratat e ndërtimit. Standardi i ri është i bazuar në parimin se të ardhurat njihen kur kontrollin e një transfereve të mira apo të shërbimit ndaj klientit. Standardi i ri është i bazuar në parimin se të ardhurat njihen kur kontrollin e një transfereve të mira apo të shërbimit ndaj klientit. Standardi lejon ose një retrospektive të plotë apo një qasje të modifikuar retrospektive përmiratim. (I detyrueshëm për vitet financiare që fillon më ose pas datës 1 janar 2018).*
- *Ndryshimet në SNRF 16 "Qiratë". SNRF 16 është lëshuar në janar 2016. Kjo do të rezultojë në pothuajse të gjitha qiratë e njobura në bilanc, duke qënë se dallimi ndërmjet qirasë operative dhe financiare është hequr. Sipas standardit të ri, një aset (e drejta për të përdorur aset me qira) dhe një detyrim financiar për të paguar qiranë janë të njobura. Kontabilizimi i qiradhënsit nuk ka ndryshime të konsiderueshme. (I detyrueshëm për vitet financiare që fillon më apo pas datës 1 janar 2019.)*
- *Ndryshimet në SNK 12 "Tatimet mbi të ardhurat", është lëshuar në janar 2016. Kjo do të qartësojë njohjen e aktiveve tatimore të shtyra përmblidhet e parealizuara. (Efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 janarit 2017).*
- *Ndryshimet në SNK 7 "Pasqyra e Flukseve Monetare" është lëshuar në janar 2016. Kjo qartëson se njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese që mundësojnë përdoruesit e pasqyrave financiare të vlerësojnë ndryshimet në detyrimet që rrjedhin nga aktivitetet financuese. (Efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 janarit 2017).*

Kompania ka zgjedhur të mos i përvetësojë këto standarde, rishikime dhe interpretime para datës që ato do të bëhen efektive. Kompania parashikon se përvetësimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të këtë ndikim material në pasqyrat financiare të kompanisë në periudhën e aplikimit fillestar të tyre



**3. Bazat e përgatitjes**

**3.1 Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

**3.2 Baza e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

**3.3 Biznesi në vijimësi**

Pasqyrat financiare të shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

**3.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

**3.5 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve**

Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar kërkon që Drejtimi të bëjë gjykimet, vlerësimet dhe supozimet të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë si pasojë e këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël nijhen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

Informacionet në lidhje me zonat e rëndësishme të vlerësimit të pasigurisë dhe gjykimit kritik në aplikimin e politikave kontabël të cilat më së shumti ndikojnë në paraqitjen e shumave në pasqyrat financiare, janë paraqitur në shënimin nr. 5.

**4. Politika të rëndësishme kontabël**

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë aplikuar në të gjitha periudhat e pasqyruara në këto pasqyra financiare dhe në mënyrë të vazhdueshme nga shoqëria.

**4.1 Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.



**AYEN AS ENERGJI sh.a**  
**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**  
*(Vlerat janë në Lek)*

**4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**  
**4.1 Transaksionet në monedhë të huaj (vazhdim)**

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 është detajuar si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2016</b>	<b>31 dhjetor 2015</b>
Euro / LEK	135.23	137.28
USD / LEK	128.17	125.79
GBP / LEK	157.56	186.59

**4.2 Instrumenta financiarë**

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimi me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksi që lidhet me to, përvèç sic përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten sic përshkruhet më poshtë.

Një instrument finansiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit finanziar ose kur shoqëria transferon aktivin finanziar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërise skadojnë, shfuqizohen ose anullohen.

*Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre*

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

*Llogari të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimi me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij finansiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizonit llogaritet si diferençë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

*Llogaritë e pagueshme*

Llogaritë e pagueshme dhe të tjera janë deklaruar me vlerën e drejtë dhe më pas me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

*Huatë*

Huatë janë njohur fillimi me vlerën e drejtë, neto nga kostot e transaksioneve dhe më pas njihen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, me shpenzime interesit të njohura bazuar në normën efektive.

Metoda e interesit efektiv është metoda e llogaritjes së kostos së amortizuar të detyrimit finansiar dhe e alokimit të shpenzimit të interesit përgjatë periudhës përkatëse. Norma efektive e interesit është norma që skonton saktësisht vlerat e ardhshme të parave përgjatë jetëgjatësisë së planifikuar të detyrimit finansiar, ose kur është e përshtatshme, për një periudhë më të shkurtër vlerën e mbetur neto nga njohja fillestare.



## **AYEN AS ENERGJI sh.a**

**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

(Vlerat janë në Lek)

### **4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

#### **4.2 Instrumenta financiarë (vazhdim)**

##### *Vlera e drejtë*

Vlerat e drejta të përllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

##### *Të tjera*

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

##### *Kapitali aksionar*

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale.

##### *Zhvlerësimi i aktiveve financiare*

Një aktiv finanziar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin finanziar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferençë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### **4.3 Inventari**

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacetetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme.

#### **4.4 Aktive afatgjata materiale**

##### *(i) Njohja dhe matja*

Zérat e aktiveve afatgjata materiale janë matur me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi i akumuluar.

Kostot përfshijnë shpenzimet që janë të lidhura direkt me blerjen e aktivit. Kosto e aktivit të ndërtuar vetë përfshin koston e materialeve dhe punës direkte dhe çdo kosto tjetër direkte të lidhur me vënien e aktivit në kushtet e punës për përdorimin e parashikuar, kostot e çmontimit dhe heqjen e pjesëve dhe restaurimin e zonës në të cilat ato janë vendosur dhe kostot e huamarrjes së kapitalizuara. Programi i blerë që është pjesë përbërëse në funksionimin e një pajisjeje është kapitalizuar si pjesë e pajisjes.

Kur pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato llogariten si zëra të ndara (pjesë të rëndësishme) të akteveve afatgjata materiale.

Fitimet ose humbjet nga nxjerra jashtë përdorimit e ndonjë zëri të akteveve afatgjata materiale janë përcaktuar duke krahasuar të ardhurat e marra nga nxjerra jashtë përdorimit me vlerën kontabël (neto) të akteveve afatgjata materiale dhe janë pasqyruar neto në të ardhura të tjera në pasqyrën e fitimit ose humbjes.



**AYEN AS ENERGJI sh.a**  
**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**  
*(Vlerat janë në Lek)*

**4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**  
**4.4 Aktive afatgjata materiale (vazhdim)**

*(ii) Kostot vijuese*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të pronave, makinerive dhe pajisjeve është njojur në vlerën kontabël (neto) të pjesës në qoftë se është e mundur që në të ardhmen të mirat ekonomike të përfshira në atë pjesë do t'i vijnë Shoqërisë dhe kostoja mund të matet me besueshmëri. Vlera kontabël (neto) e pjesës që zëvendësohet hiqet nga regjistimet. Kostot e shërbimeve të përditshme të pronave, makinerive dhe pajisjeve janë të njoitura në të ardhurat ose shpenzimet kur ndodhin.

*(iii) Amortizimi*

Amortizimi është llogaritur mbi vlerën e amortizueshme, e cila është kostoja e aktivit duke zbritur vlerën e mbetur. Amortizimi njihet me normat si më poshtë në bazë të vlerës së mbetur:

Toka	Nuk amortizohet
Ndërtesa, makineritë dhe paisjet e Hidrocentralit	5%
Kontenier	20%
Mjetet e transportit	20%
Pajisje kompjuterike	25%
